



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SHOQËRIA RAJONALE  
UJËSJELLËS KANALIZIME ELBASAN sha

Elbasan më: \_\_\_\_/ \_\_\_\_/ 2024

**PROCESVERBAL**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE  
DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROKURIMIT:**

**“Supervizion punimesh për objektin “Rikonstruksion i plotë i Ujësellsave të fshatrave Kotorr dhe Storr, si dhe ndërtimi i Ujësjellësit të Ri, Liras, Njësia Administrative Pishaj.”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**(71247000-1 “mbikqyrja e puneve te ndërtimit)**

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**1.912.081.67 (një milion e nentëqind e dymbëdhjetë mijë e tetëdhjetë e një presje gjashtëdhjetë e shtate) Monedha, pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, të VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan” sha**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, mbështetur në projektin dhe preventivin e miratuar, me përmbajtjen si më poshtë:

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10,
- c. Formularin e Ofertes sipas Shtojcës 1

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

## **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sipas Shtojcës 10**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

a. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2021, 2022, 2023) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar. Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk kanë raporte negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

**Shënim:** Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, germa “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05. 03. 2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, në Ligjin Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 10091 datë 05. 03. 2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

b. Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (2021, 2022, 2023) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros **për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar** duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, në Ligjin Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe nenin 43, nenin 55, pika 4 të VKM Nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori

ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

- c. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023 si dhe këstin përkatës për vitin 2024, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30. 10. 2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. *Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, në Ligjin Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM Nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, dhe në ligjin nr. 9632, datë 30. 10. 2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr. 9920 datë 19. 05. 2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr. 131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 9723 datë 03. 05. 2007 “Për QKR” i ndryshuar.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

### **Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:**

**2.3.1** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo më e vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuara gjatë tri viteve të fundit.

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e mbikëqyrjes, formularin e vlerësimit për realizimin e shërbimit të mbikëqyrjes dhe faturat tatimore të shitjes, ku të shënohen datat, shumat si dhe objekti i mbikëqyrjes së realizuar.

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e mbikëqyrjes, formular vlerësimi/vërtetim për realizimin e shërbimit të mbikëqyrjes ku të shënohet vlera, afati i kontratës dhe objekti i mbikëqyrjes së realizuar si dhe faturat tatimore të shitjes, ku të shënohen datat, shumat si dhe objekti i mbikëqyrjes së realizuar.

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën e bashkimit të operatorëve dhe prokurën e posaçme, të deklaruara në fazën e tenderimit.
- Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën bazë ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor, kontratën e nënkontraktimit dhe aktin e miratimit zyrtar si nënkontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23. 12. 2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin **Licensë profesionale** për “**Mbikëqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi**”, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mëposhtme, sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi:

- **N.P-1** (Punime gjurmimi e toke)
- **N.P-7** (Ujësjiellësa, gazsjiellësa, vajsjiellësa,)
- **N.S.-18** (Punime topogjeodezike,)
- **N.S.-20** (Shpime gjeologo-inxhinier,)

**Argumentimi:** Kategoritë e vendosura janë kërkuar bazuar në shërbimin që do të realizohet sipas objektit të prokurimit.

Operatori ekonomik që do të realizojë shërbimin e mbikëqyrjes duhet të zotërojë licensën profesionale me pikat e sipërpërmendura.

Kjo kërkesë është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23. 12. 2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar, nenin 41, pika 4, germa ”a” të VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021 “*Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 759 datë 28. 12. 2016, i ndryshuar.

**2.3.3** Një punësim mesatar i të paktën 12 (dymbëdhjetë) personave, për periudhën të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për minimumin 3(tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar si dhe listëpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, (*Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*).

**Argumentimi:** Këto kërkesa për stafin janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23. 12. 2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar, nenin 41, pika 4, germa ”c” të VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021 “*Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*” i ndryshuar. Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zërat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të shërbimit, që është përlllogaritur në një kohë i cili kërkon fuqi punëtore të shtuar për zbatimin me sukses të kësaj kontrate.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore dhe stabilitetin e saj ka kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listëpagesat e punonjësve mbështetur edhe në pikën 6 të VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021 “*Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*” i ndryshuar, sipas së cilës: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

**Stafi inxhinierik që do të realizojë mbikëqyrjen është kërkuar në përputhje me stafin inxhinierik të nevojshëm për zbatimin e punimeve, zërat përkatës të preventivit si dhe me projektin e zbatimit të punimeve.**

**2.3.4** Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik Drejtues Teknik për kryerjen e të gjitha shërbimeve të mbikëqyrjes, të përfshirë në licensën e

shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi;
- 2 (dy) Inxhinier Hidroteknik;
- 1 (një) Inxhinier Elektrik;
- 1 (një) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder;
- 1 (një) Inxhinier Mekanik.
- 1 (një) Inxhinier Gjeolog

**Argumentimi:** AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23. 12. 2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”.

**Stafi inxhinierik që do të realizojë mbikëqyrjen është kërkuar në përputhje me stafin inxhinierik të nevojshëm për zbatimin e punimeve, zërat përkatës të preventivit si dhe me projektin e zbatimit të punimeve.**

**2.3.5** Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik ndihmës për kryerjen e shërbimeve të mbikëqyrjes, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse, licence individuale për mbikëqyrje si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi;

**Argumentimi:** AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik ndihmës është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23. 12. 2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”.

**Stafi inxhinierik ndihmës që do të realizojë mbikëqyrjen është kërkuar në përputhje me stafin inxhinierik të nevojshëm për zbatimin e punimeve, zërat përkatës të preventivit si dhe me projektin e zbatimit të punimeve.**

### 2.3.6

- a) Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, në përputhje me klauzolat Ligjit Nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, Neni 49, pika 4, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/certifikatë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit, të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, Grupimi duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin). ose duke lënë mundësinë e disponimit të këtij punonjësi nga operatori ekonomik edhe nëpërmjet **kontraktimit**.

**Argumentimi:** AK argumenton se kërkesa për *Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga Zjarri dhe për shpëtim* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23. 12. 2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19. 05. 2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 41, si dhe në mbështetje të Nenit 49, pika 4 të Ligjit Nr.152/2015, “*Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin*“, ku citohet: “*Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së jep certifikatë për personat fizikë e juridikë për ushtrimin e aktivitetit të ekspertit zjarrfikës privat, në bazë të kriterëve të veçanta të miratuara me udhëzim të ministrit*”.

- b) 1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë “*Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave*”, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/certifikatë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (*Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”*).
- c) 1 (një) punonjës me certifikatë “*Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë*” në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 “*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*” dhe V.K.M Nr. 312, date 05. 05. 2010 “*Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”*”, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/certifikatë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave (*Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”*).
- ç) 1 (një) punonjës me certifikatë “*Ekspert për ndikimin e vlerësimit në mjedis*” (VNM) të pajisur me certifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/certifikatë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (*Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”*).

**Argumentimi:** Kjo kërkesë është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23. 12. 2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar, neni 41, pika 4, germa (b) të VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021 “*Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 7 të Ligjit 10237, datë 18. 02. 2010 “*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*”, sipas të cilit: “*Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarrës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....*”. Për shkak të natyrës së punimeve që kryhen shihet e nevojshme dhe e domosdoshme prania e 1 (një) punonjësi të pajisur me certifikatë “*Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave*”.

### 2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a) Certifikatën e menaxhimit të cilësisë **ISO 9001:2015** (e vlefshme, ose ekuivalente), e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga

Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO 9001:2015)

- b) Certifikatën e menaxhimit të mjedisit **ISO 14001-2015** (e vlefshme, ose ekuivalente), e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO 14001-2015.
- c) Certifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit **ISO 45001-2018**, (e vlefshme, ose ekuivalente), e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO 45001-2018.
- d) Certifikatën e menaxhimit të energjisë **ISO 50001-2018** (e vlefshme, ose ekuivalente), e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO.
- dh) Certifikatën e menaxhimit të cilësisë në Saldim **EN-ISO 3834-2:2021** (e vlefshme, ose ekuivalente), e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën EN-ISO 3834-2:2021.

**Argumentimi:** Kërkesat e cilësisë të përcaktuara janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr.285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

**Shënim:** Kandidati ofertues në përllogaritjen e ofertës duhet t’i referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25. 07. 2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik “Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 354 datë 11. 05. 2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim””.

**Shënim:** Kandidati ofertues në përllogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25. 07. 2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik “Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 354 datë 11. 05. 2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim””.